



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_ .10.2023

**Lënda:** Përgjigje kërkesës së paraqitur nga Avokat P.Ç.  
Adresa: Rruga e Kavajës, kompleksi Delijorgji Godina \_\_\_\_ Hyrja , Ap  
E-mail : \_\_\_\_\_@gmail.com

**TIRANË**

I nderuar z. Ç,

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, nr. 1530 prot datë 12.09.2023 (tonën) dërguar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (Autoriteti) me anë të së cilës në referencë të Nenit 11 të ligjit nr 55/2018 “Për profeionin e avokatit në RSH“ ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” neni 2 dhe neni 3, Kodi i Procedurave Administrative neni 63, dhe pikës 1.1 të nenit 20 të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” i ndryshuar, kërkohet vënia në dispozicion e materialeve të ish- Sigurimit të Shtetit për 2 (dy) shtetase, konkretisht:

1. Znj. G.(T.) B.
2. Znj. S.Zh.(L) ju informojmë se :

Objekti i kërkesës për informacion i nënshtrohet pjesërisht ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” për informacionin që në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit” konsiderohet informacion publik.

Për këtë informacion Autoriteti, në zbatim të plotë të legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit, mbështetur në parimin e transparencës dhe aksesit në informacion, në mënyrë të vazhdueshme publikon në faqen e tij zyrtare web (lutem referohuni në link-un: <http://autoritetidosjeve.gov.al/> ) ekstrakte të vendimeve që merr për shtetasit në cilësinë e kërkuarit apo zyrtarët që emërohen/ngrihen në detyrë për të cilët kërkohet informacion nga institucionet emëruese sipas nenit 29 të ligjit nr 45/2015.

Sa më sipër me Vendimin nr. 6, datë 17.02.2017, Autoriteti ka informuar institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me rezultatin e procedurës së vlerësimit të cilësive etiko-morale të kandidatëve për tu zgjedhur si anëtarë të Komisionit të pavarur të Kualifikimit ku midis kandidatëve të tjerë përfshihen edhe shtetasit për të cilat kërkohet informacion se - nga kërkimet e deritanishme, nuk ekzistojnë të dhëna që kandidatet znj. B. dhe znj. Zh., të kenë qenë bashkëpunëtor apo të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit.

**Kordinatori i të drejtës për informim pranë Autoritetit**

**L. Cocoli**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**Në mungesë dhe me Urdhër**

**Drejtori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Financave**

**Sofi Noti**